

VENDIM
Nr. 178, datë 4.11.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË FTL SHA,
PËR DISA NDRYSHIME NË “RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E
SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 103/2016 TË BORDIT TË
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “I”, 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; VKM-së nr. 244/2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; nenit 21, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë. 23.6.2016, të ndryshuar; nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/3, datë 12.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesës së FTL sh.a., për rishikimin e pikës 1/c, të nenit 11, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Shoqëria FTL sh.a., me shkresën nr. 2773 prot., datë 23.9.2020, ka parashtruar kërkesën për rishikimin e pikës 1/c, të nenit 11 të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin nr. 103/2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.

- FTL sh.a. bën me dije, se shoqëritë e huaja të regjistruara në platformën IT *online* të blerjes së energjisë elektrike, në mënyrë të vazhdueshme, kanë shprehur shqetësimin lidhur me pamundësinë e tyre për përditësimin në afatin e përcaktuar prej 3 muajsh, të dokumentacionit sipas përcaktimit të pikës 1/c, të nenit 11 të Rregullores, për shkak të afateve të procedurave administrative në shtetet përkatëse dhe të kostove financiare të përditësimit të këtij dokumentacioni.

- Duke pasur në konsideratë që disa nga shoqëritë pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë elektrike janë shoqëri të huaja, si dhe referuar praktikave më të mira të industrisë dhe precedentëve lokale, në lidhje me tregtimin e energjisë elektrike, FTL sh.a. propozon që afati i përditësimit të dokumentacionit sipas pikës 1/c, të nenit 11, të rregullores, të bëhet 12 (dymbëdhjetë) muaj.

- Shoqëria FTL sh.a. e bazon kërkesën për ndryshimin e pikës 1/c, të nenit 11, të rregullores së sipërcituar, së pari në eliminimin e kostove financiare të përditësimit të dokumenteve çdo 3 (tre) muaj dhe së dyti referuar praktikave më të mira të industrisë dhe precedentëve lokale në lidhje me tregtimin e energjisë elektrike.

- Bazuar në nenin 19, germa “I”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka përgjegjësinë për të miratuar, me propozim të të licencuarve rregullat, për: i. shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik. Në kuptim të sa më sipër, FTL sh.a. legjitimohet si palë interesi për të kërkuar rishikimin e kësaj rregulloreje.

- “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin nr. 103/2016, e ndryshuar, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, gjatë shqyrtimit e miratimit të saj ka kaluar në një proces të gjatë konsultimi me palët e interesit, si dhe është miratuar me konsultim të ngushtë me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë (ENC-në).

- Në zbatim të rregullave të praktikës së ERE-s, për këto ndryshime do të njoftohen të gjitha palët e interesit, veçanërisht OST sh.a., si palë direkte, e cila, gjithashtu, zbaton këtë rregullore për procedurat e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, si dhe Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë, për të shprehur opinionet e tyre, në lidhje me këto propozime për ndryshim.

- Për shqyrtimin dhe vlerësimin e drejtë të këtij propozimi do të shërbejnë, gjithashtu, konsultat që do të kryhen me praktikantët më të mira vendësë dhe ndërkombëtare, si dhe organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin nr. 103/2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, si më poshtë:

a) afati i përditësimit të dokumentacionit të parashikuar në pikën 1, germa “c”, të nenit 11 të rregullores, të bëhet 12 (dymbëdhjetë) muaj.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti